

# Radiodifuzerët

Spektori mediatik në Republikën e Maqedonisë së Veriut përbëhet nga tre segmente: (1) servisi publik (Radiotelevizioni i Maqedonisë), (2) televizionet dhe radiot komerciale dhe (3) radiot joprofitabile.

Emetimi i radios dhe televizionit mund të bëhet vetëm në bazë të lejes, që e jep Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale. Periudha e vlefshmërisë së lejeve për emetim televiziv ose të radios është nëntë vite me mundësi për vazhdimin e saj, gjithashtu për 9 vite.

Për momentin kemi gjithësejt **107 radiodifuzerë, prej të cilëve 43 televizione dhe 64 radio**. Prej televizioneve, 11 emetojnë program në nivel shtetëror (5 përmes multipleksit, 4 përmes operatorëve kabllor dhe 2 përmes satelitit); (17 në nivel rajonal) (6 përmes multipleksit dhe 11 përmes operatorëve kabllor) dhe 15 televizione lokale (përmes operatorëve kabllor).

Prej radiove, 4 emetojnë program në nivel shtetëror, 16 në nivel rajonal (prej të cilave një është joprofitabile) dhe 44 në nivel lokal (3 janë joprofitabile).

**Agjencia realizon mbikëqyrje të punës së radiodifuzerëve në më shumë aspekte: Mbrojtjen e publikut të mitur, reklamimit, sponsorisimit, plasimit të prodhimeve, obligimeve për emetimin e muzikës si dhe për programet e krijuara burimore...**

Për çdo mbikëqyrje të realizuar përpilohet raport. Nëse konstatohet shkelje, radiodifuzerit i shqiptohet masa e vërejtjes, respektivisht nëse vazhdon me përsëritjen e të njëjtës shkelje ligjore, gjatë vitit i shqiptohet procedurë për kundërvajtje, para gjykatës kompetente.

## **TELEVIZIONET**

- Regjistri i televizioneve
- Formularë dhe dokumente për TV
- Pasqyra e procedurave për kundërvajtje
- Koncepti programor për shërbimet programore televizive

## **RADIOT**

- Regjistri i radiove
- Formularë dhe dokumente për RA
- Pasqyra e procedurave për kundërvajtje
- Koncepti programor për shërbimet programore të radios